




Fondi i Grave të Kosovës

Grante të Vogla, Ndryshime të Mëdha **2013**



© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2013

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, derisa autorët citohen. Ky publikim është realizuar me mbështetjen e Kvinna till Kvinna. Qëndrimet në këtë publikim janë qëndrime të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës dhe nuk paraqesin në asnjë mënyrë mendimet e Kvinna till Kvinna.

www.womensnetwork.org

Printuar nga Night Design në Prishtinë, Kosovë



Kvinna till Kvinna

Përmbajtja

Fondit i Grave të Kosovës	4
Si funksionon Fondi i Grave të Kosovës?	6
Komuna mbështet OJQ-në <i>Gruaja Hyjnore</i> për fuqizimin e grave	8
“Tregu” Ngrit Vetëdijesimin për të Drejtat e Grave dhe Krijon të Ardhura	10
“Venera” Ofron Ndihmë Ligjore Falas	12
Gratë Fermere i Zhvillojnë Shkathtësitë e Tyre Afariste	14
Gratë e Verbëra Sjellin Brailin në Shkollë	16
Trajnimet në Bujqësi i Fuqizojnë Gratë.....	18
Prehja Vetëdijeson Gratë për Kancerin e Gjirit.....	19
Shoqata Institucionalizon Shërbimet e Interpretimit për Personat e Shurdhër	20
Foleja Ofron Edukim Shëndetësor	23
Të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale Kërkojnë Drejtësi	24
Ikebana Kultivon Çajra Bimorë në Mënyrë të Pavarur.....	26
Kontroll Falas për 75 Gra	28
Gratë Inkuadrohen në Fushën e Turizmit.....	29
Gratë e Dragashit Sigurojnë Një Treg të Ri.....	30
Bliri Shtron Diskutime Rreth Marrëdhënieve Seksuale	31

Fondit i Grave të Kosovës

Që nga pranvera e vitit 2012, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka dhënë 34 grante, apo në total 66,209 €, për organizatat anëtare të saj nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës. Nga këto nisma kanë përfituar drejtpërdrejtë **1,883 gra të ndryshme** duke përfshirë gra me aftësi të kufizuara fizike, nga zona rurale, me prejardhje etnike të ndryshme (p.sh. turke, gorane, serbe, rome, ashkalike, egjiptase, dhe shqiptare) si dhe të reja dhe pensioniste. Edhe më shumë njerëz brenda komuniteteve kanë përfituar në mënyrë të tërthortë. Këto grante të vogla (deri në €3,000) kanë bërë ndryshime të mëdha brenda periudhave të shkurtëra kohore. Kjo broshurë tregon rrëfimet e tyre.

Por së pari, ne dëshirojmë t'ju njoftojmë me historikun e Fondit të Grave të Kosovës. Me mbështetjen bujare nga Kvinna till Kvinna dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), RrGGK e ka themeluar këtë Fond për të siguruar grante të vogla për organizatat e grave të cilat nuk kanë qasje në burime tjera të financimit. Fondi i Grave të Kosovës është themeluar pas një sërë konsultimesh gjatë vitit 2012 me organizatat anëtare të RrGGK-së lidhur me nevojat dhe vizionin e tyre për Fondin.

Fondi i Grave të Kosovës plotëson nevojat thelbësore për të mbështetur organizatat e grave në kohën e zhvendosjes së prioriteteve të ndihmës në Kosovë. Zvogëlimi i buxhetit ka detyruar shumë donatorë në Kosovë t'i mbyllin programet e tyre të granteve ose t'i zvoglojnë fondet për organizatat jo-qeveritare. Donatorët tjerë kanë fonde të cilat është jashtëzakonisht e vështirë të arrihen nga organizatat lokale. Grupet e grave të cilat kanë pak njohuri të gjuhës angleze kanë vështirësi në marrjen e fondeve të tilla. Megjithatë, organizatat e udhëhequra nga gratë janë në pozitë të mirë për të ndërmarë nisma shumë efikase dhe efektive për barazinë gjinore dhe të drejtave të grave në nivel komunal, siç e ka dëshmuar Fondi i Grave të Kosovës. Përmes Fondit të Grave të Kosovës, ne përpiqemi të sigurohemi që përpjekjet e tyre të rëndësishme të vazhdojnë të mbështeten.

Të arriturat kryesore të Fondit të Grave të Kosovës

- Më shumë se 2,811 gra dhe vajza kanë përfutur deri më sot
- Ngritja e kapacitetit të anëtareve të RrGGK-së për të shkruar propozime
- Anëtare të ndryshme të RrGGK-së, duke përfshirë grupet rurale dhe minoritare, kanë qasje në fonde
- Zyrtarët Komunal për Barazi Gjinore dhe institucione të tjera janë përfshirë në nismat e anëtareve të RrGGK-së
- Anëtarët e RrGGK-së kanë fituar shkathtësi në avokim duke përdorur metodën “mësimi përmes praktikës”. Anëtarët e RrGGK-së kanë siguruar bashkë-financim substancial për nismat e tyre
- Kërkesë e lartë për vazhdimin e Fondit të Grave të Kosovës
- Anëtarët e RrGGK-së dhe përfitueset kanë ndërmarrë nisma shtesë në baza vullentare pas përfundimit të projekteve fillestare
- Anëtarët e RrGGK-së janë të njohura për publikun përmes televizionit, mediave online, gazetave, uebfaqes së RrGGK-së dhe Facebook-ut.

Si funksionon Fondi i Grave të Kosovës?

Tri herë në vit organizatat anëtare të RrGGK-së inkurajohen që të dorëzojnë aplikacionet për nismat që do të kontribuojnë në realizimin e qëllimeve strategjike të identifikuar në Planin Strategjik të RrGGK-së 2011-2014. Vetë anëtares e RrGGK-së i kanë përzgjedhur këto qëllime përmes një procesi konsultativ. Ato përfshijnë:

- Forcimi i RrGGK-së dhe anëtareve të saj
- Mbështetja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendim-marrje
- Përmirësimi i qasjes së grave në kujdes cilësor shëndetësor
- Lufta kundër dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore
- Fuqizimi ekonomik i grave

Organizatat e grave mund të aplikojnë për fonde në gjuhën shqipe edhe në atë serbe, duke përdorur Formularin e Aplikimit i cili gjendet në dispozicion në faqen e internetit të RrGGK-së (www.womensnetwork.org). Për të aplikuar për grante në Fondin e Grave të Kosovës, organizata duhet të jetë anëtare e RrGGK-së; t'i planifikojë dhe zbatojë aktivitetet në përputhje me strategjinë e tyre organizative; të ndër marrë aktivitete që kontribuojnë në Planin Strategjik të RrGGK-së; të arrijë personat dhe grupet e synuara dhe / ose në rrezik; si dhe të ketë mungesë të mundësive të tjera për të siguruar fonde.

Që nga janari i vitit 2013, nismat e mbështetura nga Fondi i Grave të Kosovës kanë zgjatur deri në gjashtë muaj dhe kanë marrë deri në 3,000 €. Komiteti Shqyrtues i Granteve i Fondit të Grave të Kosovës, i cili zgjidhet çdo vit nga anëtares e RrGGK-së, takohet tri herë në vit për të vendosur nëse propozimet e granteve i plotësojnë kriteret e lartpërmendura të përshtatshmërisë si dhe për të dhënë grante duke përdorur një sistem të bazuar në pikë.

RrGGK gjithashtu ofron mundësi për ngritjen e kapaciteteve për aplikantët e granteve dhe përfituesit e granteve për t'i forcur organizatat tona anëtare si dhe rrjetin tonë. RrGGK ofron punëtori praktike si dhe mentorim individual në përpilimin e granteve, menaxhimin e ciklit të projektit, si dhe menaxhimin financiar, duke zhvilluar edhe më tej kapacitetin e organizatave për të aplikuar për fonde tek donatorët e tjerë në të ardhmen.

Mbështetja e RrGGK-së për përfituesit e granteve nuk përfundon me ndarjen e një granti. Ne vazhdojmë sigurimin e mentorimit individual për çdo përfitues të grantit gjatë gjithë kohëzgjatjes së nismës së tyre, dhe shpesh edhe më gjatë. Kjo përfshin vizitat në vendndodhje, zhvillimin e shkathtësive në menaxhimin financiar, ndihmën në menaxhimin organizativ, këshilla në lidhje me strategjitë avokuese efektive, lehtësimin e rrjetëzimit me zyrtarë qeveritarë, si dhe në zgjidhjen e problemeve. Ne gjithashtu i mbështesim anëtarët tona të mendojnë në mënyrë proaktive në lidhje me qëndrueshmërinë, që përfshin planifikimin e nismave si dhe arritjen e mbështetjes në nivel të komunitetit gjë që do t'ua mundësojë nismave të tyre të vazhdojnë përtej kohëzgjatjes së planifikuar të këtyre projekteve të shkurtëra. Në vitin 2013, RrGGK-ja ka siguruar më shumë se 300 sesione mentoruese për anëtarët e saj nëpërmjet telefonit, e-mailit, ose kontaktit personal.

Për më shumë informata në lidhje me Fondin e Grave të Kosovës, vizitojeni faqen tonë të internetit: <http://www.womensnetwork.org/?FaqelD=33>. Personeli i RrGG-së mund të ofrojë informata shtesë përmes e-mailit grants@womensnetwork.org apo përmes telefonit +381 (0)38 245 850. Ju lutemi, na kontaktoni nëse organizata juaj është e interesuar për të mbështetur Fondin e Grave të Kosovës.

“Jemi shumë mirënjohëse për mbështetjen që kemi nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës përmes Fondit të Grave të Kosovës.”
- Një anëtare e RrGGK-së

Komuna mbështet OJQ-në *Gruaja Hyjnore* për fuqizimin e grave

Në rajonin e Gjilanit shumë gra janë të papunësuar. Pa punësim dhe pa të ardhura, gratë e kanë vështirë të marrin pjesë në vendim-marrje edhe brenda familjeve të tyre, të mos flasim për në sferën publike. Shumë gra gjithashtu nuk kanë njohuri në lidhje me të drejtat e tyre të trashëgimisë dhe të barazisë gjinore.

Duke i njohur mirë sfidat që hasin gratë brenda komunitetit të tyre, OJQ-ja *Gruaja Hyjnore* (Divine Woman) është përcaktuar për edukimin e grave në lidhje me të drejtat e tyre, si dhe mbështetjen e tyre në krijimin e të ardhurave për t'i fuqizuar ato ekonomikisht. Ato besojnë se duke i njohur të drejtat e tyre, si dhe me pavarësi më të madhe ekonomike, do të mund të fuqizohet pjesëmarrja e grave në vendim-marrje.

Edhe pse OJQ-ja *Gruaja Hyjnore* kishte operuar në mënyrë informale që nga viti 2005, ajo nuk mund të përballonte qiranë për zyre. Mbështetja nga Fondi të Grave të Kosovës (2,420 €) iu mundësoi që të avokojnë me sukses në mënyrë që komuna e Gjilanit t'u sigurojë hapësirë zyreje falas për aktivitetet e organizatës. Që nga maji i vitit 2013, komuna e Gjilanit ka siguruar një vend pa pagesë për përdorim për këtë organizatë. Ky bashkëpunim me komunën i ka mundësuar OJQ-së *Gruaja Hyjnore* t'i zvoglojë shpenzimet e saj operative, duke kontribuar ndjeshëm në qëndrueshmërinë e organizatës.

“Komuna e Gjilanit është duke u përpjekur t’iu kushtojë më shumë vëmendje të drejtave dhe interesave të grave, pasi që ne e dimë se roli i grave në shoqëri është i padiskutueshëm,” tha Omer Daku, Zëvendës Kryetar i Komunës së Gjilanit. “Ne, si komunë, jemi duke u përpjekur të krijojmë më shumë hapësira për gratë në mënyrë që të veprojnë dhe të ndërmarrin më shumë aktivitete.”

Gruaja Hyjnore e përdor hapësirën e saj për t'i fuqizuar ekonomikisht gratë. Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës, ato organizuan 10 punëtori për barazi gjinore, për të drejtat e grave

në trashëgiminë e pronës, si dhe teknikat e përparuara në artin e punëdore për 40 gra të moshës 25 deri 40 vjeç.

“Aktivitetet e OJQ-së më kanë ndihmuar, si grua e pa arsimuar, që të shpëtoj nga rutina e përditshme; Takoj gra të tjera; Shkëmbej përvoja; Marr pjesë në trajnime për teknika të reja të punimeve me dorë; I paraqes punimet e mia në ekspozita të ndryshme; dhe mbi të gjitha, të ndihem më e vlerësuar,” tha Alije Ajeti, pjesëmarrëse. “Diçka tjetër tepër e rëndësishme është se kam mundur t’i shes punimet e mia. Kështu kam mbështetur edhe familjen. Tani, edhe bashkëshorti më mbështet më shumë.”

Gruaja Hyjnore gjithashtu ka bashkëpunuar me strehimoren në Gjilan, duke i ftuar gratë të marrin pjesë në punëtoritë e saj. Kjo ishte një mundësi ekskluzive për gratë të cilat kanë përjetuar dhunë për të mësuar se si të bëjnë punime dore, të cilat më pas mund t’i shesin. Veç kësaj, leksionet mbi trashëgiminë e pronës dhe barazinë gjinore janë mjaft të dobishme. Ato kanë kërkuar që *Gruaja Hyjnore* të vazhdojë të organizojë aktivitete të ngjashme edhe në të ardhmen.

Përveç fitimit të njohurive për të drejtat e tyre, nëpërmjet kësaj nisme 36 gra kanë patur mundësi t’i shesin produktet e tyre në panairë. Katër gratë nga strehimorja e grave kanë fituar afërsisht 400 euro në total nga shitja e produkteve të tyre. Kjo nismë ka kontribuar në fuqizimin e grave, si nga ana ekonomike ashtu edhe në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes në procesin e vendim-marrjes në familje.



Gruaja Hyjnore feston hapjen e zyrës që iu është dhënë pa pagesë nga Komuna e Gjilanit.

“Tregu” Ngrit Vetëdijesimin për të Drejtat e Grave dhe Krijon të Ardhura

“Tregu i Grave” në Sheshin “Nëna Terezë” si risi në Prishtinë, shet produkte të grave dhe në të njëjtën kohë organizon evenimente në rrugë për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e grave.

Nga vera e vitit 2013, Tregu i Grave, i drejtuar nga OJQ-ja Rikotta, ka filluar të shesë çdo ditë prodhime të pjekura të përgatitura nga gratë në këtë shesh të mbushur me njerëz, i cili gjendet pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Këtë verë, gjashtë gra përfituan dhe i çuan në shtëpi fitimet nga shitjet e tyre. Falë kësaj nisme, një grua tepër punëtore ka arritur të fitojë deri në 780 euro në muaj gjatë tre muajve.

Përveç ndihmës së dhënë anëtareve të saj për të fituar ca të ardhura shtesë, Rikotta e përdor këtë hapësirë publike për të organizuar fushata në rrugë: 1. Për të mbledhur të mira materiale për gratë të cilat kanë përjetuar dhunë në familje dhe trafikim; 2. për fëmijët me Sindromin Down; 3. dhe për fëmijët me Autizëm.

Rikotta e hapi këtë Treg sepse ishte e brengosur nga mungesa e iniciativave qytetare për të çuar më tej të drejtat dhe pjesëmarrjen e grave në jetën publike.

“Nismat e qytetarëve janë iniciativa shumë të mira për nxitjen e solidaritetit mes organizatave të grave, si dhe barazisë gjinore,” tha Pranvera Bullaku, Drejtoreshë Ekzekutive e Rikotta-s.

“Tregu i Grave” është një nismë e ndërmarrë në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, e cila e ofroi pa pagesë vendin ku zhvillohen aktivitetet ndryshme. Agim Gashi, Drejtor i Departamentit për Shërbime Publike pranë Komunës së Prishtinës, hapi zyrtarisht “Tregun e Grave” më 12 gusht.

“Ne synojmë t’i mbështesim të gjitha nismat pozitive të qytetarëve të Prishtinës, veçanërisht ato nisma të cilat përqendrohen tek të drejtat e grave dhe puna e rëndë e tyre,” tha Agim Gashi.

Kjo iniciativë gjithashtu është mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës. Rikotta mori një grant prej 2,990 € në korrik të vitit 2013.

Duke u mbështetur në bashkëpunimin pozitiv me kryetarin e Komunës, Tregu i Grave do të mund të parashtrojë sërish kërkesë në qershor 2014 për një hapësirë të lirë në Sheshin “Nëna Terezë” për muajt e verës.

Publiciteti dhe mbulimi mediatik i “Tregut të Grave” ka tërhequr vëmendjen e grave të tjera të cilat janë të interesuara për t’iu bashkuar kësaj nisme. Në vitin 2014 pjesë e Tregut të Grave do të bëhen edhe katër gra përfaqësuese të OJQ-ve tjera.

Megjithëse Tregu i Grave nuk do të vendoset në shesh gjatë muajve të dimrit, gratë do të angazhohen në vazhdimin e punimeve të tyre. Për të mësuar për nismat e tyre dhe/ose për të blerë produkte të prodhuara nga gratë, mund të telefononi në numrin tonë të telefonit: +377 (0)44 429 432.



Pranvera Bullaku e OJQ Rikotta-s duke shitur produkte të grave në “Tregun e Grave” në Sheshin “Nëna Terezë” në Prishtinë.

“Venera” Ofron Ndhimë Ligjore Falas

Pak kosovarë mund të paguajnë për avokat kur kanë nevojë për këshillim apo asistencë ligjore. Prandaj, OJQ-ja Venera në Pejë ka marrë kërkesa nga qytetarët për ndihmë për çështje të ndryshme ligjore. Në të njëjtën kohë, avokatet e reja i janë bashkangjitur Venerës për shqetësimet e tyre: si të reja, ato përpiqen të sigurojnë punë në Pejë apo përvojë pune e cila do t’iu mundësonte të aplikonin për punë në vende të tjera. Duke kuptuar sfidat me të cilat përballen të rejtat dhe qytetarët e lokalitetit, përfaqësuesve të OJQ-së Venera iu erdhi një ide novatore.

Venera vendosi të bëjë një projekt pilot, një nismë e vogël nëpërmjet së cilës avokatet e reja do të ofronin ndihmë ligjore falas për njerëzit të cilët nuk mund ta përballojnë atë ekonomikisht. Në të njëjtën kohë, ato do të plotësonin nevoja të rëndësishme në kuadrin e komunitetit të tyre.

Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (2,666 €), Venera punësoi dy avokate të reja, të cilat, në gusht të vitit 2013, filluan t’iu ofrojnë qytetarëve shërbime ligjore falas.

“Dikur punoja si avokate në Kuvendin Komunal,” tha Shqipe Sheremeti, avokate në “Venera”. “Por kjo punë më përmbush shumë. Këtu jam më afër njerëzve dhe mund t’i ndihmoj ata.”

Nën drejtimin e kujdesshëm të avokates me përvojë Miradije Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive, deri në nëntor organizata ka ndihmuar 17 persona të cilët përndryshe nuk do të kishin patur qasje në shërbime të tilla. Kjo ka përfshirë, mes të tjerash, ndihmën me autorizime zyrtare, këshillimin ligjor, dhe pagimin dhe/ose kundërshtimin e gjobave. Gjithsej, organizata iu ka ofruar klientëve të saj pa pagesë shërbime ligjore në vlerë prej 2,570 €.

“I kisha shkruar aq shumë kërkesa Kuvendit Komunal për problemin tim,” tha një prej klientëve të Venerës. “Por këtu

me Miradijen, Shqipen dhe Syzanën është ndryshe. Ato janë shumë të sjellshme dhe mund të flasësh lirshëm. U gëzova shumë kur më ofruan ndihmë falas.”

Megjithëse mbështetja për Venerën nga Fondi i Grave të Kosovës përfundoi në 30 nëntor, nga puna e saj deri më sot mund të shihet se nevojat janë të mëdha. Ajo po vazhdon të punojë në baza vullnetare, duke përfshirë asistimin e klientëve në mbarimin e proceseve të cilat i kanë filluar. Ajo planifikon t’i paraqesë kërkesë Fondit të Grave të Kosovës, si dhe donatorëve të tjerë në të ardhmen, për të shtuar numrin e përfituesve gjatë viteve në vijim.



*Miradije Gashi
Sheremeti, nga
Venera, duke
përgatitur
dokumentacionin
si pjesë e
përpjekjeve të
organizatës për të
ofruar ndihmë
ligjore falas
njerëzve në nevojë
në Pejë.*

Gratë Fermere i Zhvillojnë Shkathësitë e Tyre Afariste

Krusha e Vogël bën pjesë tek zonat më të prekura nga lufta e vitit 1999 në Kosovë. Jo vetëm që secila familje ka humbur disa anëtarë të familjes (veçanërisht burra dhe djem), por edhe mjetet e jetesës kur është djegur tërë qyteza.

Menjëherë pas luftës, u themelua Shoqata e Fermereve të Krushës së Vogël, për të mbështetur gratë, në mënyrë të veçantë kryefamiljaret, në zhvillimin e aftësive si fermere, me qëllim që të mund të gjenin mënyra mbijetese. Përveç grave të Krushës së Vogël, Shoqata gjithashtu ka përfshirë edhe gra nga disa fshatra pranë, duke përfshirë Hasin, Randobravën, dhe Piranën.

Shoqata nuk është një shoqatë tipike e fermerëve në kuptimin që ajo i bashkon mundësitë për zhvillim për anëtarët e saj me mbështetje psiko-sociale. Përsa i takon vitit 2013, 180 anëtarët e shoqatës janë aftësuar në punime artizanale, bujqësi dhe blegtori. Tani shoqata angazhohet të gjejë mënyra për menaxhimin më të mirë të punës së saj, me qëllim që të bëhet më e fuqishme ekonomikisht. Në këtë bënin pjesë avancimi i njohurive mbi mënyrën e hapjes dhe drejtimit të bizneseve të vogla. Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (2,390 €), Shoqata ka mundur të mbështesë anëtarët e saj në përmirësimin e cilësisë së prodhimeve të tyre, në drejtim të përmirësimit të shitjeve.

Për shembull, disa anëtare të Shoqatës kanë pasur probleme me qumështin i cili prishej përpara se të shitej. Dile Prekpalaj, afariste me përvojë, Drejtoreshë Ekzekutive e Shoqatës, i ndihmoi fermeret se si të përmirësonin higjienën e qumështit. Si rezultat, 22 gra kanë mundur të rrisin jetëgjatësinë e qumështit, dhe të ardhurat e tyre mujore, gjithsej 160 € në muaj.

Dymbëdhjetë gra, të cilat janë duke u specializuar në punimet artizanale, kanë marrë këshilla praktike për

menaxhimin më të mirë dhe tregtimin e produkteve të tyre, duke përfshirë shkathtësitë në menaxhim të biznesit. Tetë prej tyre shitë produktet e tyre, dhe fituan përafërsisht 120 €.

Ndërkohë, anëtarët e cilat janë duke punuar në bujqësi kanë mësuar teknika të mbjelljes, si dhe strategji për menaxhimin e suksesshëm të bizneseve. Një grup prej 19 fermeresh vizituan fshatin Koretin në Komunën e Kamenicës, ku kanë mësuar nga Skender Dervishi dhe Ibrahim Bunjaki, pronarë të “Qendrës së Fidanëve”.

“Kjo vizitë ka mbështetur shkëmbimin e eksperiencave në fushën e bujqësisë,” tha një pjesëmarrëse. “Ekspertët kanë shpjeguar se si e drejtojnë biznesin e tyre, cilat filiza i kultivojnë, si dhe mënyrën e procesit të mbjelljes.” Gratë patën mundësinë të mësonin mënyra konkrete për organizimin më të mirë të mbjelljes së fidaneve, si dhe të shihnin lloje të reja të filizave të cilat nuk i kishin parë asnjëherë më parë.

“Trajnimet kanë qenë shumë të rëndësishme për ne,” tha një anëtare. “Kjo vizitë ishte diçka e dobishme. Kaluam shumë bukur dhe mësuam shumë gjëra të reja.”

Përvoja nuk ishte vetëm arsimore, por edhe përforcuese. Për disa gra, kjo ishte hera e parë që udhëtonin jashtë fshatit të tyre.

Ndonëse projekti përfundoi në korrik, tetë gra planifikojnë të hapin bizneset e tyre në të ardhmen, ku do të vazhdojnë të përdorin njohuritë të cilat i fituan nëpërmjet kësaj nisme.



Anëtarët e Shoqatës së Femereve nga Krusha e Vogël duke mësuar mbjelljen dhe teknikat e punës.

Gratë e Verbëra Sjellin Brailin në Shkollë

Megjithëse fëmijët e verbër kanë të drejtë të frekuentojnë shkollat publike, ndonjëherë këtyre u mungojnë kushtet e mjaftueshme për t'i pranuar ata ose nuk pranohen mirë për shkak të paragjytimeve të gabuara lidhur me aftësitë e tyre për të mësuar.

Komisioni i Grave të Verbëra i ka përfshirë të rinjtë në ngritjen e vetëdijesimit mes drejtorëve të shkollave, mësimeve dhe nxënësve për sfidat me të cilat përballen nxënësit e verbër, nevojat e tyre dhe rëndësinë e përdorimit të alfabetit brail në shkolla.

“Nga ju kërkoj të merrni nota të mira në shkollë dhe të jepni shembullin e nxënësit të shkëlqyer, me qëllim që t'i bindim njerëzit të na ndihmojnë që të arrijmë qëllimin tonë,” u tha Bajramshahe Jetullahu, të rinjve të verbër të cilët ishin mbledhur në shtator për të mësuar për nismën dhe për t'u bërë pjesë e saj.

Komisioni i Grave të Verbëra kërkoi të inkurajohen të rinjtë për të mbrojtur të drejtat e tyre për arsimim, mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (€2,878).



Të rinjtë e verbër duke testuar Tabelat e Brailit të dhuruara nga Komisioni për shkolla.

“Nevoja jonë më e madhe është që të na kuptojnë qytetarët,” tha një pjesëmarrëse e re. “Ata duhet të kuptojnë se asnjëherë nuk dihet se çfarë sjell jeta. Ndoshta një ditë edhe ata do të bëhen [të verbër] si ne, dhe do të kenë nevojë për dikë që t'i ndihmojë.”

Në bashkëpunim të ngushtë me dy drejtorë të shkollave, Komisioni ka futur



Bajramshahe duke ua shpjeguar Brailin nxënësve në Prishtinë.

tabelat e alfabetit të Brajlit në dy shkolla fillore në Prishtinë. Tabelat me madhësi pothuaj sa ajo e shtatit të një njeriu, janë përdorur për të shpjeguar alfabetin e Brajlit nxënësve të shkollave publike. Kështu, prezantimi i tabelave ka përfshirë gjithashtu edhe organizimin e leksioneve në alfabetin e Brajlit për rreth 140 nxënës dhe mësime, si dhe ndarjen e informatave për nevojat e veçanta që kanë nxënësit e verbër.

Nxënësit morën pjesë në mënyrë aktive në këto diskutime, duke bërë pyetje nga kurioziteti. Disa nxënës, të mrekulluar, morën shënime për tabelat e Brajlit në fletoret e tyre.

“A mund të më prisni, ju lutem,” tha një nxënës. “Sa të marr fletoren, sepse dua t’i shkruaj këto shpjegime dhe t’ua tregoj familjes dhe shokëve.”

Përveç prezantimit të Brajlit në shkollë, nisma i informoi nxënësit dhe familjet e tyre për sfidat me të cilat përballen të verbërit dhe mbështetjen të cilën mund ta ofrojë shoqëria. Komisioni i Grave të Verbëra beson se nisma të tilla për ngritjen e vetëdijesimit mund të kontribuojnë në zbatimin e Ligjit për Arsimin Para-universitar, i cili i jep secilit nxënës të drejtën për të mësuar në shkollat publike dhe për të marrë arsimim themelor.

Në të ardhmen, Komiteti ka në plan të avokojë tek Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ta përdorur këtë aktivitet si një shembull për vendosjen e tabelave të ngjashme të Brajlit në shkolla të tjera fillore anembanë Kosovës.

Trajnimet në Bujqësi i Fuqizojnë Gratë

Për shkak të kufizimeve nga shoqëria, shumë gra në fshatrat e Komunës së Lypjanit kanë liri të kufizuar të lëvizjes. Sylbije Sahiti, Drejtoreshë Ekzekutive e *Parajsës Sonë*, gjeti një mënyrë për t'i tejkaluar këto kufizime: organizimi i trajnimeve në kopshtari, kultivim të frutave dhe perimeve, pasterizim të ushqimit, dhe marketing të produkteve. Këto çështje ngjallën kaq shumë interes sa që më shumë sesa 120 femra të moshës nga 18 deri 55 vjeç, kanë marrë pjesë në trajnim. Gratë shpesh kanë ofruar shtëpitë e tyre si vende për zhvillimin e trajnimeve.

“Jam shumë e lumtur të ofroj këtë hapësirë me gratë,” tha Hanifja, një pjesëmarrëse, e cila ofroi kopshtin e saj për organizimin e trajnimit. “Gratë e kanë të vështirë të largohen nga shtëpia. Ky është një justifikim i shkëlqyer për t’iu larguar rutinës së përditshme.”

Gjatë trajnimeve të organizuara këtë verë, Sylbija iu tregoi grave se si të mbillnin fara dhe përdori shkathtësitë e saj prej udhëheqëse për t’i motivuar ato. Ato do të mund të marrin nisma për të fituar vetë para dhe madje të nisin një biznes të tyre, tha ajo. “Është kënaqësi t’i ndani idetë me të tjerët dhe t’i bëni ëndrrat realitet,” u tha grave, të cilat ishin ulur në karrike plastike në lëndinë në trajnimin në fshatin Krojmir. “Në fillim, kur e mora këtë nismë, nuk kam patur mbështetje nga familja ime. Bashkëshorti im nuk mendonte se mund t’ia dilja mbanë. Megjithatë, sot ai e ka parë suksesin dhe është mjaft mbështetës. Tani mund të siguroj të ardhura për familjen time,” tha ajo. “Unë besoj se secila prej jush ka ide të papërsëritshme; mund të bëhet e suksesshme dhe të arrijë të fitojë para për veten dhe familjen.”

Për këtë nismë gjashtë-mujore, “Parajsa Jonë” ka marrë mbështetje nga Fondi i Grave të Kosovës (2,656 €).

Prehja Vetëdijeson Gratë për Kancerin e Gjirit

Shumë gra në Kosovë nuk mund ta përballojnë pagesën e kujdesit shëndetësor ose kontrollet parandaluese të cilat mund t’iu mundësojnë atyre diagnostifikimin e kancerit në fazat e hershme, duke i përmirësuar mundësitë për trajtimin e tij.

“Shumica e grave fshehin sëmundjen,” tha një grua. “Ato mendojnë se është turp [të ankohen për sëmundjet] dhe se duhet ta durojnë dhimbjen. Ato ndihen keq t’u tregojnë burrave të tyre se janë të sëmura, sepse e dinë që kujdesi shëndetësor kushton, dhe familjet e tyre nuk kanë para të mjaftueshme për shërim.”

Prandaj, me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (2,160€), Qendra e Grave *Prehja* ka vendosur t’i mësoj gratë nga zonat rurale se si të bëjnë vetë-kontrollimin për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit.

“Vetëm vitin e kaluar në komunën tonë kanë vdekur gjashtë gra nga kanceri i gjirit,” tha Jeton Rushiti, Koordinator i projektit në *Prehja*. “Ato nuk kishin kushte të mira ekonomike për të kryer kontrole të rregullta mjekësore. Projekti ynë ka për qëllim të ngris vetëdijesimin e grave për parandalimin e kancerit të gjirit. Ne mendojmë se nismat e tilla kanë një rol jetik në vetëdijesimin e grave për kancerin e gjirit, si dhe iu mundësojnë atyre të bëjnë kontrole mjekësore falas.”

Prehja ka organizuar ligjërata për të ngritur vetëdijesimin në lidhje me kancerin e gjirit në katër fshatra të Skenderajt në maj të vitit 2013.

“Është me rëndësi jetike që të bëni vizita të rregullta mjekësore,” tha Dr. Maloku-Krasniqi para 200 grave të cilat morën pjesë në ligjërata. “Vetëm në këtë mënyrë mund të marrim masa parandaluese dhe të luftojmë kancerin e gjirit,” tha ajo.

Prehja planifikon të vazhdojë t’i ndihmoj gratë që vuajnë nga kanceri i gjirit duke organizuar diskutime vetë-mbështetëse, ku gratë mund të flasin me psikologë si dhe të këshillohen se si të përballen me kancerin në aspektin emocional.

Shoqata Institucionalizon Shërbimet e Interpretimit për Personat e Shurdhër

Nëse kontrollet gjinekologjike paraqesin probleme për shumicën e grave kosovare, gratë e shurdhëra përballen me probleme shtesë. Ato duhet t'i tejkalojnë stereotipet negative të përhapura për gratë që vizitojnë gjinekologët, sidomos ata meshkuj, si dhe t'ua shpjegojnë problemet e tyre shëndetësore gjinekologëve duke përdorur gjuhën e shenjave. Madje edhe atëherë, gratë e shurdhëra nuk mund ta kuptojnë diagnozën ose udhëzimet e gjinekologëve për trajtim pa ndihmën e një interpreti.

Shoqata e të Shurdhërve në Prizren është përpjekur ta eliminojë këtë sfidë duke angazhuar interpretë të gjuhës së shenjave për t'i shoqëruar gratë e shurdhëra tek gjinekologu. Nisma e tyre, e mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (1,312 €), ka ndihmuar pesë gra që të dalin nga shtëpitë e tyre të pavarura nga anëtarët e familjes, disa prej tyre për herë të parë. Për më tepër, më shumë se 25 gra të reja kanë mësuar teknikat për tejkalimin e sfidave me të cilat ato përballen në jetën e tyre të përditshme.

Përmes vizitave gjinekologjike u zbulua se një grua e shurdhër kishte probleme shëndetësore. Me anë të kësaj vizite, ajo ishte në gjendje ta identifikojë këtë problem në fazën e hershme. Vizitat e rregullta tek gjinekologu, me ndihmën e Shoqatës, i kanë mundësuar asaj ta trajtojë këtë problem dhe të shërohet shpejt.

Më tej, përmes kësaj iniciative, Shoqata avokoi me sukses kështu që Zyrtari Komunal për Barazi Gjinore dhe Drejtoria e Shëndetësisë institucionalizuan shërbimet e gjuhës së shenjave. Shumë shpejtë, Komuna punësoi një interpret i cili tani ofron shërbime të interpretimit në Kuvendin Komunal dhe në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dy herë në javë.

Megjithatë, arritja e këtyre sukseseve nuk ishte e lehtë. Gjatë kësaj nisme, gratë janë përballur me një mori sfidash, duke përfshirë diskriminimin nga kolegët meshkuj brenda Shoqatës së tyre. Për këtë arsye, rezultat tjetër i kësaj nisme ishte që gratë e shurdhëra në korrik të vitit 2013 vendosën të themelojnë Shoqatën e Grave të Shurdhëra në Prizren. Shoqata e re ka për qëllim të fuqizojë gratë e shurdhëra dhe të kujdeset për sfidat unike me të cilat ato ballafaqohen *për shkak* se janë gra me nevojë.

“Unë doja që ato të kenë më shumë hapësirë, pasi që kjo hapësirë nuk ofrohej në OJQ-në tjetër deri më tani,” tha Krenare Ajdini, një interprete e cila i kishte mbështetur gratë në themelimin e Shoqatës së re.

Krenarja nisi rrugën e saj si aktiviste e të drejtave të grave gjatë punës si interprete e gjuhës së shenjave gjatë takimeve të Rrjetit të Grave të Kosovës. Ajo mori pjesë në takimin e saj të parë në vitin 2012 si interprete për Shoqatën e Personave të Shurdhër. “Gjatë atij takimi mësove shumë informata të reja për OJQ-të dhe punën e tyre.” “Kur pashë mundësitë që rrjeti i ofron për gratë,



Krenarja duke përkthyer për të rinjët e shurdhër, duke i inkurajuar t'i diskutojnë nevojat e tyre.

vendosëm që të themelojmë një organizatë të re për gratë e shurdhëra,” tha ajo.

Krenarja e pranon që themelimi i një organizate të re nuk është punë e lehtë: hartimi i statutit, formimi i bordit si dhe çështjet e tjera administrative. Megjithatë, “stafi i RrGGK-së ishte gjithmonë i gatshëm për të më ndihmuar në lidhje me dokumentet, procedurat dhe çdo çështje tjetër,” tha ajo.

“Deri më tani, unë jam me të vërtetë e kënaqur me interesimin dhe bashkëpunimin e treguar për anëtarët e OJQ-së tonë,” tha Krenarja. “Së bashku ne jemi duke punuar në gjetjen e mënyrave për funksionalizimin dhe financimin e ideve tona. Në këtë mënyrë ne do të jemi në gjendje t’i fuqizojmë gratë e shurdhëra në komunën tonë.”

Foleja Ofron Edukim Shëndetësor

Në Prizren, shumë vajza rome, ashkalike dhe egjiptase e braktisin shkollën para përfundimit të arsimit të detyrueshëm, shpesh për shkak të martesave të hershme. OJQ *Foleja* vendosi të organizojë një tryezë për diskutime për të informuar nënat, familjet, dhe gratë e reja për rëndësinë e arsimit, si dhe për të siguruar informata për kujdesin shëndetësor, të cilat ato mund të mos kishin përjetuar.

Foleja ftoi një doktoreshë për t'i vizituar gratë rome, ashkalike dhe egjiptase në lagjet e tyre. Gjatë disa bisedimeve intime, ajo ofroi informata në lidhje me sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe se si të shmangët shtatzënia e padëshiruar. Nënat gjithashtu kanë marrë broshura me këshilla për kujdesin për foshnjat e tyre.

“Ky projekt është shumë i rëndësishëm për edukimin e grave të reja rreth asaj se si të krijojnë familje të shëndosha si dhe për gjërat themelore që ato duhet të dinë në mënyrë që t'i rrisin foshnjat e tyre,” tha Gjyzel Shaljani, Drejtoreshë e *Folesë*. Gjatë ligjëratave interaktive, pjesëmarrëset mund t'i bënin pyetje doktoreshës si dhe të merrnin udhëzime për adresimin e sfidave me të cilat përballen.

“Unë jam shumë e kënaqur me punën që Gjyzelja dhe doktoresha janë duke bërë,” tha Lindita Qylangji, një pjesëmarrëse. “Në këto takime ne mësojmë shumë.”

Më shumë se 400 gra kanë marrë informata nëpërmjet nismës së *Folesë*, të mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (2,740 €).



Gratë duke i diskutuar sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë një trajnimi në Prizren.

Të Mbijetuarat e Dhunës Seksuale Kërkojnë Drejtësi

Të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë ende nuk u kushtohet vëmendje e mjaftueshme nga udhëheqësit politikë të Kosovës. Çështja e dhunës seksuale gjatë luftës nuk është ngritur në negociatat mes Kosovës dhe Serbisë. Asnjëherë nuk është kërkuar falje zyrtare për krimet e kryera ndaj grave, ndërsa për dënime apo dëmshpërblime nga gjykata as që bëhet fjalë.

Në përgjithësi, shoqëria i ka izoluar dhe nuk i ka mbështetur gratë të cilat kanë pësuar nga ky krim i tmerrshëm. Si rezultat, shumë gra janë përpjekur që të vazhdojnë jetën e tyre pa ditur asnjëherë se si të përballen në aspektin psikologjik me dhimbjen e tyre. Kjo shpesh ka rezultuar me pasoja të rënda shëndetësore, duke përfshirë traumat, fobinë, si dhe lëndimet e pashëruara fizike. Identifikimi i grave të cilat kanë përjetuar krime të tilla është me rëndësi esenciale në mënyrë që tu sigurohet ndihma shumë e nevojshme në zhvillimin e mekanizmave të përballimit të cilët do t'iu mundësojnë atyre të jetojnë jetën e tyre.

Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave në vitin 2012i ka filluar përpjekjet për t'i ndihmuar gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës, ato qendra kanë rehabilituar 37 gra, të cilat i ka gjurmuar në 13 fshatra të rajonit të Drenasit, tek organizatat e specializuara në ofrimin e rehabilitimit psikologjik dhe mjekësor. Për më tepër, qendra ka organizuar takimin e këtyre grave me Presidenten e Kosovës Atifete Jahjaga, për t'i identifikuar dhe paraqitur tetë kërkesa në emër të grave të mbijetuara.

Përpjekja e tyre ishte aq e suksesshme sa që ato kanë marrë mbështetje shtesë nga Fondi i Grave të Kosovës në vitin 2013 (2,707 €), që iu ka mundësuar t'i rrisin arritjet e

vitit të kaluar duke i ndihmuar gratë edhe në 15 fshatra të tjera. Gjithsej, që nga viti 2012, ata kanë ndihmuar 69 gra.

“Heshtja është thyer,” tha Kadire Tahiraj nga kjo Qendër. “Ne kemi punuar me vullnet të madh, dhe e vlerësojmë ndihmën dhe mbështetjen që kemi nga Rrjeti i Grave të Kosovës.”

Përveç sigurimit të mbështetjes psikologjike dhe ndihmës mjekësore, qendra i ka inkurajuar dhe mbështetur gratë që t’i shprehin nevojat e tyre tek institucionet publike. Kjo ka përfshirë edhe mundësinë unike për këto gra që të takohen me Presidenten e Kosovës Atifete Jahjaga, në mënyrë që t’i shprehin me fjalë shqetësimet e tyre dhe të kërkojnë mbështetje institucionale. Pas marrjes së tetë kërkesave të tyre vitin e kaluar, Presidentja Jahjaga i ka vizituar gratë në vitin 2013 ku kanë kërkuar që qeveria të plotësojë nevojat e tyre.

“Çelësi i jetës sonë është hapur,” tha një grua e cila ndihmohet nga Qendra. “Po më jepni shpresë për të vazhduar jetën. Unë ndjehem më e fuqishme, dhe nuk do të ndalem deri sa drejtësia të vihet në vend.”

Ikebana Kultivon Çajra Bimorë në Mënyrë të Pavarur

Një grup ndëretnik i grave në Shtërpce gjithmonë kishte ëndërruar për të krijuar një organizatë përmes të cilës ato do të mund të mbledhin dhe t'i shisinin çajrat bimorë. Ato kishin për qëllim të përgatisnin produkte me përbërës cilësor në mënyrë miqësore ndaj mjedisit. Disa bimë mjekësore me të cilat ato dëshironin ti kultivonin janë mjaft të njohura në industrinë farmaceutike. Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (2,707 €) dhe nga Caritas Switzerland, ato ia arritën qëllimit për të realizuar ëndrrën e tyre, duke hapur organizatën e tyre, "Ikebana".

Themelimi i një organizate të re nuk është detyrë e lehtë. Anëtarët e Ikebanas kishin nevojë për mbështetje në mënyrë që të vinin në funksion sistemin, politikat dhe procedurat në mënyrë që organizata e tyre të funksionojë



Anëtarët e Ikebanas duke tharë barishtet në Shtërpce.

në mënyrë të pavarur. Anëtarët e stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës i mentoruan ato në zhvillimin e aftësimin e tyre. Ato gjithashtu blenë makina për tharjen dhe prodhimin e çajit. E filluan punën, duke mësuar nga njëra-tjetra. Po ashtu morën pjesë në trajnime ku morën informata teorike dhe praktike. Ato i kanë përdorur njohuritë e tyre për të filluar mbledhjen dhe prodhimin e çajit në qershor. Edhe pse filluan si një grup i vogël, me kalimin e kohës grupi i tyre është duke u rritur.

“Ne ishim vazhdimisht në kërkim të një mënyre për të filluar punën, për të treguar se ne mund të punojmë,” tha Ankica Zivkovic, Drejtoreshë Ekzekutive e Ikebana-s. “Tani me fondet nga RrGGK, ne po e shfaqim potencialin tonë. Jemi shumë mirënjohëse për Fondin e Grave të Kosovës që na ofruan këtë mundësi.”

Kontroll Falas për 75 Gra

Shumë gra rome, ashkallike dhe egjiptase nuk ishin në dijeni për pasojat e mundshme nga mos kontrollit të mjeku. Disa gra e dinë rëndësinë, por nuk mund ta përballojnë pagesën për tu vizituar te mjeku, ndërsa të tjerat nuk u besojnë punëtorëve shëndetësorë.

Duke i ditur këto çështje nga përvoja e tyre e mëhershme me gra rome, ashkallike dhe egjiptase në Mitrovicë, OJQ *Lulebora* vendosi të organizojë ligjërata me gjinekologen Vjollca Thaqi, me mbështetje nga Fondi i Grave të Kosovës (1370 €). Tri herë në javë ajo ofronte informata në lidhje me higijenën personale, kontrceptivët, kancerin e gjirit dhe mitrës. Ato diskutuan gjithashtu për rëndësinë e vizitës tek gjinekologu. Gjatë ligjëratave, gratë angazhoheshin në mënyrë aktive, duke bërë pyetje.

“Shumica e grave as nuk e dinin madje se çfarë është kanceri i gjirit”, tha Albulena Sinanaj, koordinatore e projektit në *Lulebora*. “Ato e dinin vetëm se është një sëmundje. Me ndihmën e gjinekologes, ato mësuan se si t’i identifikojnë simptomat e mundshme të kancerit të gjirit.”

Pas ligjëratave, *Lulebora* organizoi për më shumë se 75 gra vizita tek një gjinekologe, shumë prej tyre për herë të parë. Zyrtari Komunal për Barazi Gjinore e ka mbështetur këtë nismë, duke kërkuar nga Drejtoria e Shëndetësisë që spitalet publike të ofrojnë kontrolle falas. Kjo nismë gjithashtu i ka mundësuar Zyrtarit për

Barazi Gjinore të përmbushë qëllimin e tij: sigurimin e qasjes më të mirë në sistemin e kujdesit shëndetësor për gratë në nevojë.

“Ky projekt është shumë i veçantë për ne,” tha Drita Salihu, një pjesëmarrëse. “Ka qaq shumë gra që nuk mund të përballojnë pagesën për tu vizituar te mjeku. Unë jam shumë mirënjohëse që *Lulebora* na ndihmon me kujdes të veçantë.”



Gratën duke pritur radhën, gjatë vizitës falas tek gjinekologu.

Gratë Inkuadronen në Fushën e Turizmit

Shumë gra të Novobërdës i kalojnë kohën në shtëpi, duke u kujdesur për fëmijët dhe duke bërë punët e shtëpisë. Gjatë dimrit me borë, ato mbyllen brenda dhe i kalojnë ditët dhe netët duke qepur dhe endur. Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim i ka frymëzuar gratë të bëhen aktive jashtë shtëpive të tyre ndërkohë që mund të kontribuojnë në shtimin e të ardhurave në familje. Fondacioni është përqendruar që të arrihet qasja te gratë kryefamiljare dhe te ato që varen nga ndihma sociale e shtetit.

Fondacioni ka filluar me organizimin e trajnimeve për prodhimet, marketingun dhe tregjet, me mbështetje nga Fondi i Grave të Kosovës (2.600 €). Në shtator, ato u kanë ndihmuar grave për hapjen e kjosqeve në natyrë në një lokacion të rëndësishëm, afër Qendrës Turistike të Novobërdës. Aty gratë do të mund t'u shesin prodhimet e bëra turistëve që vizitojnë kalanë e Novobërdës.

“Ky projekt është shumë i rëndësishëm për ne,” tha një grua. “Kjo nuk ka të bëjë vetëm me fitimin, por na ka aktivizuar dhe mundësuar të dalim nga shtëpia. Unë përgatis disa lloje të reçelit, çajrave poashtu dhe punë dore. Tani mund t'i shes këto prodhime. Njerëzit më telefonojnë dhe më pyesin për prodhimet e mia.”

Sipas Vjollca Zeqirit, Drejtoreshë e Fondacionit, kjo nismë jo vetëm që ka kontribuar në përmirësimin e gjendjes ekonomike të 10 grave, por edhe i ka mbështetur gratë në aspektin psikologjik. “Tani gratë mund t'i shesin në verë prodhimet që i kanë bërë gjatë dimrit.” “Pa marrë parasysh kohën kur i përgatisin prodhimet, me përkushtim dhe dashuri, çdo prodhim mund të shitet në cdo kohë,” tha ajo.



Gratë duke ua shitur prodhimet e tyre turistëve në Novobërdë.

Gratë e Dragashit Sigurojnë Një Treg të Ri

Gratë e Dragashit kanë shkathtësi unike në prodhimin e rrobave tradicionale të punuara me dorë. Megjithatë, pasi që ato jetojnë lartë në male, pak gra mund të kenë qasje në tregje për t'i shitur prodhimet e tyre. Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (2,800 €) dhe Kuvendit Komunal të Prishtinës, OJQ *Rona* i ka ndihmuar gratë nga Dragashi të kenë qasje në një treg të ri në Prishtinë.

Punëdoret shumë ngjyrëshe të grave, të punuara artistikisht, e kanë zbuluar Bulevardin Nëna Terezë për tetë ditë gjatë muajit tetor. Nëntëmbëdhjetë organizata të grave nga gjithë Kosova, duke përfshirë edhe Dragashin, kanë shitur mesatarisht nga më shumë se 500 € për një organizatë (gjithsej 9500 €).

“Ky projekt ishte shumë i dobishëm, sidomos për gratë nga Opoja e Dragashit,” tha Serbeze Sylejmani, Drejtoreshë e OJQ *Rona*. “Ato nuk kishin mundësi për t'i shitur prodhimet e tyre më parë.” Kjo nismë u mundësoi po ashtu edhe grave nga organizatat e tjera nga tërë Kosova që t'i shesin prodhimet e tyre, tha ajo.



Në Sheshin Nëna Tereza, klientët duke i shikuar prodhimet e bëra nga gratë prej Opoje të Dragashit.

“Panairot janë gjithmonë të mirëpritura,” tha Xhejrane Lokaj, një aktiviste e të drejtave të grave, e cila punon gjithashtu në Dragash. “Jam shumë mirënjohëse për Rrjetin e Grave të Kosovës për mbështetjen e OJQ-së *Rona* në organizimin e këtij panairi. Përveç sigurimit të fitimit financiar për gratë, ne po e ruajmë kulturën dhe traditën e punës së dorës.”

Bliri Shtron Diskutime Rreth Marrëdhënieve Seksuale

Marrëdhënia seksuale paramartësore është një temë tabu në shumë zona rurale në mbarë Kosovën. Pak prindër diskutojnë me fëmijët e tyre për marrëdhënien seksuale, e sidomos me bijat e tyre. As sistemi shkollor publik nuk siguron edukim të mjaftueshëm seksual.

Prandaj, mes gushtit dhe nëntorit, OJQ *Bliri* ndërmori iniciativën për të ftuar mjekë të cilët mund t'ua shpjegonin vajzave se si të mbrohen nga shtatzënia e hershme, në mesin e çështjeve të tjera të shëndetit riprodhues. Gjithsej 740 nëna dhe vajza kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në këto diskutime. Disa prej tyre asnjëherë më parë nuk kanë pasur mundësi t'i diskutojnë këto tema së bashku.

“Ne e kemi ngritur vetëdijen e grave që nuk kanë shkuar kurrë në shkollë dhe që kurrë nuk kanë marrë pjesë në trajnime të tilla më parë,” tha Mahije Ismajli, Drejtoreshë e *Blirit*. Prandaj, ajo e konsideronte këtë nismë të suksesshme.

Gjatë këtyre takimeve, gratë gjithashtu kanë mësuar se si të bëjnë vetë-kontrollimin për të identifikuar kancerin e gjirit në fazat e hershme.

“Jeta është fat,” tha një pjesëmarrëse. “Njeriu kurrë nuk mund ta dijë nëse do të ketë kancerin e gjirit ose jo. Prandaj, është shumë mirë që tani e di se si t'i kontrolloj gjinjtë e mi për të parandaluar kancerin e gjirit.”

Bliri planifikon një hulumtim në lidhje me gjendjen shëndetësore dhe nevojat e grave dhe vajzave në rajonin e tyre. Ata do ta përdorin këtë hulumtim për t'i njoftuar me rekomandimet e tyre institucionet si dhe akterët e tjerë.

Nisma e *Blirit* ka marrë mbështetje nga Fondi i Grave të Kosovës (€2,500).

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Hajdar Dushi Rr. C-2 II/8

10000 Prishtinë, Kosovë

+381 (0) 38 245 850

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

grants@womensnetwork.org

[Facebook: Kosova Women's Network](#)

Printim ekologjik.